



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr.18 Tirane

Tel/Fax 04 2226814 ; 2226814

Nr. 294/7 prot.

Tiranë 20.06.2016

**V E N D I M**

Nr. 69 datë 20/06/2016

**Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 294/2 prot., datë 20.04.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për verifikimin e ligjshmërisë së zhvillimit të ecurisë disiplinore ndaj punonjësit \*\*\*\*\***

Në mbështetje të neneve 11, 14, 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, ligjit nr. 8485, dt. 12.5.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të RSH", referuar nenit 185 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" dhe nenit 13, 14 gërma "a" dhe 34, të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të materialit të administruar dhe relacionit të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë si në aspektin e respektimit të procedurës, ashtu dhe përmbajtjes së ecurisë disiplinore për punonjësin \*\*\*\*\*,

**VËREJ SE**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka marrë dijeni nëpërmjet informacionit të regjistruar me nr. 294 prot., datë 21.03.2016, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, për punonjësin \*\*\*\*\*, deklaruar si nëpunës civil në pozicionin "Specialist në sektorin e pronave dhe kadastrës", pranë Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në Bashkinë Kukës. Rezulton se, si motivacion për largimin nga shërbimi civil të këtij punonjësi, janë shkeljet e evidentuara në raportin e auditimit të ushtruar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH). Për këtë arsye, bazuar në Urdhrin nr.294/2 prot., datë 20.04.2016, ka nisur verifikimi i këtij rasti, në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë në nxjerrjen e aktit objekt i këtij hetimi administrativ.

Nga materialet e administruara, rezulton se punonjësi \*\*\*\*\* ka filluar punë në Bashkinë Kukës, me Urdhrin nr. 199, datë 25.11.2011, "Për marrje në punë", të Kryetarit të Bashkisë Kukës, në detyrën "Specialist i kadastrës urbane". Në këtë detyrë punonjësi ka qenë edhe në datën 26.02.2014, që përkon me momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil". Bazuar në nenin 67, pika 3, njësia përgjegjëse, pasi ka konstatuar faktin se ky punonjës ishte i punësuar në të njëjtin vend pune, për një periudhë më shumë se një vit, me aktin nr. 45/1, datë 01.07.2014, ka deklaruar statusin e punësimit, nëpunës civil në pozicionin "Specialist në sektorin e pronave dhe kadastrës".

Pas një muaji, me aktin nr. 508 dt. 01.08.2014 është lidhur një kontratë pune, sipas së cilës \*\*\*\*\* punësohej në të njëjtin pozicion në të cilin i ishte deklaruar statusi i punësimit si nëpunës civil, “*Specialist në Sektorin e Pronave dhe Kadastrës*” me afat 3 muaj (nga dt.01.08.2014 deri në dt.31.10.2014).

Lidhja e kësaj kontrate pune, është një veprim administrativ i panevojshëm dhe i pavlefshëm, prandaj nuk merret parasysh në analizën e kësaj mosmarrëveshje. Marrëdhënia e shërbimit civil, në bazë të nenit 1, pika 2, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” (i ndryshuar), është marrëdhënie juridike e natyrës administrative dhe jo me natyrë kontraktore, prandaj nëpunësi \*\*\*\*\* , pa të drejtë është trajtuar jashtë fushës së shërbimit civil dhe pa respektuar procedurat që parashikon legjislacioni përkatës i shërbimit civil.

Duke analizuar rrethanat e rastit të marrjes së masës për largim nga detyra të nëpunësit \*\*\*\*\* , rezulton sa më poshtë:

Në ushtrim të funksioneve të tij kontrolluese, në bazë të programit vjetor të miratuar, një ekip i institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, gjatë periudhës nëntor - dhjetor 2015, ka ushtruar auditim në Bashkinë Kukës. Në përfundim të procesit të kontrollit, është përpiluar “*Raporti përfundimtar i Auditimit*”, në të cilin, pasi janë përshkruar dhe analizuar shkeljet e konstatuara, janë dhënë rekomandime për nxjerrjen e përgjegjësive personale dhe aplikimin e masave disiplinore në raport me rëndësinë e shkeljeve të konstatuara.

Ndër të tjera, në këtë raport janë evidentuar shkelje edhe në punën e punonjësit \*\*\*\*\* , për të cilin është rekomanduar vënia përpara përgjegjësive disiplinore.

Kryetari i Bashkisë Kukës, bazuar në “*Raportin Përfundimtar të Auditit të ushtruar nga KLSH*” dhe Rekomandimeve për “*Masa disiplinore*”, me Urdhrin nr. 100, datë 11.02.2016, “*Për largim nga detyra*”, ka urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënies së punës për punonjës të \*\*\*\*\* , me motivacionin “*...për shkak të shkeljeve të përcaktuara në raportin e auditimit të KLSH*”.

Duke analizuar përmbajtjen e veprimit të mësipërm administrativ konstatohet se kjo procedurë është kryer në shkelje të rëndë procedurale. Në bazë të nenit 59, pika 2, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, kompetenca për të marrë masën disiplinore të parashikuar nga shkronja “ç” e nenit 58, të ligjit në fjalë, “*Largim nga shërbimi civil*” i takon komisionit disiplinor, nga ku rezulton se këtë akt nuk mund ta nxjerrë kryetari i bashkisë.

Kjo shkelje, në kuptim të ligjit nr. 8485, dt. 12.05.1999, “*Kodi i Procedurave Administrative të RSH*” përbën kapërcim kompetencash dhe në bazë të nenit 116, pika “b” e ligjit në fjalë, bën që akti i Kryetarit të Bashkisë Kukës, nr. 100, datë 11.02.2016, “*Për largim nga detyra*” të punonjës të \*\*\*\*\* , të jetë një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm. Një akt i tillë, në bazë të pikës 1, të nenit 117, të ligjit nr. 8485, dt. 12.05.1999, “*Kodi i Procedurave Administrative të RSH*”, nuk mund të prodhojë pasoja ligjore, pavarësisht nga fakti nëse është deklaruar, ose jo si i tillë.

Fakti që akti administrativ nr. 100, datë 11.02.2016, “*Për largim nga detyra*” është akt absolutisht i pavlefshëm, nuk përbën pengesë që ky veprim administrativ të përsëritet, por këtë radhë duke respektuar rregullat e përcaktuara në nenet 57 - 60, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe Vendimin nr. 115, dt. 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe krijimin e komisionit disiplinor*”.

Për këtë, fillimisht, bazuar në nenin 121, të ligjit nr. 8485, dt. 12.05.1999, “*Kodi i Procedurave Administrative të RSH*”, duhet të revokohet Urdhri nr.100, datë 11.02.2016, “*Për largim nga detyra*”, si një akt absolutisht i pavlefshëm dhe më pas, të rifillojë procedimi për marrjen e masës

disiplinore, duke filluar me ngritjen e komisionit disiplinor. Ky komision, sipas pikës 3, Kreu I, të Vendimit nr. 115, dt. 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe krijimin e komisionit disiplinor" është i përbërë nga 5 anëtarë dhe vepron sipas rregullave të përcaktuara në pikat 14 – 17, të Kreut II të aktit të mësipërm.

Fakti që shkelja është konstatuar nga një institucion i specializuar kontrollues, i cili vepron sipas një procedure të rregulluar hollësisht në ligj, prezumon që nëpunësi është vënë në dijeni për shkeljet e konstatuara dhe ka patur mundësi të paraqesë observacionet dhe kundërshtimet e veta, prandaj në bazë të nenit 96, pika 2, të ligjit nr. 8485, dt. 12.5.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të RSH", nuk është domosdoshmëri të shqyrtohet shkelja në këtë komision dhe të dëgjohet në seancë dëgjimore në Komisionin Disiplinor, por është detyrim që nëpunësi i interesuar të njoftohet për vendimin e këtij të fundit.

Në datën 28 maj 2016 ka hyrë në fuqi ligji nr.44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili në nenin 185 "Dispozita kalimtare", përcakton se, "Për procedurat administrative, që kanë filluar para hyrjes në fuqi të këtij Kodi, zbatohen dispozitat e ligjit nr. 8485, dt. 12.5.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar". Mbështetur në përcaktimet e kësaj dispozite, procedurat e nisura do të vijojnë sipas dispozitave të ligjit të mëparshëm.

Si përfundim, Urdhri nr. 100, datë 11.02.2016, "Për largim nga detyra" është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore dhe si i tillë, duhet të revokohet, duke krijuar mundësinë për rifillimin e procedimit disiplinor, nëpërmjet komisionit disiplinor.

Në rastin e punonjësit \*\*\*\*\*, nuk është respektuar procedura e kërkuar prej pikës 3, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" (i ndryshuar), gjë e cila, në bazë të neneve 115/a, 116/c dhe 117/1, të ligjit nr. 8485, dt.12.5.1999, "Kodi i Procedurave Administrative", e bën procesin të cënueshëm nga pikëpamja procedurale dhe të paaftë për të prodhuar pasoja ligjore. Si rrjedhojë, Urdhri nr. 100, datë 11.02.2016, "Për largim nga detyra", i Kryetarit të Bashkisë Kukës është akt absolutisht i pavlefshëm, për shkak të mosrespektimit të procedurës ligjore dhe si i tillë, duhet të revokohet.

### **Për këto arsye**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, si dhe nenin 35, të Rregullores "Mbi Procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", të miratuar me Vendimin nr.17, dt.11.03.2015

### **V E N D O S A:**

1. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse të drejtë procesin e revokimit të aktit administrativ: Urdhrit nr.100, datë 11.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë Kukës, "Për largim nga detyra", për shkak të shkeljes së rëndë të procedurës të kërkuar nga ligji, në nxjerrjen e tij.
2. Të ngrihet Komisioni i Përhershëm Disiplinor, bazuar në pikën 3, të nenit 59, të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, komision i cili, në kryerjen e procedimit administrativ, duhet të funksionojë dhe veprojë sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 115,

dt. 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave *"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe krijimin e komisionit disiplinor"*.

3. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative lihet afat **30** ditë nga marrja dijani për këtë vendim. Njësia përgjegjëse duhet të zbatojë vendimin duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij.
4. Me kalimin e këtij afati, të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e vendimit.
5. Të njoftohen për këtë vendim, Bashkia Kukës dhe punonjësi \*\*\*\*\*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**